

Raporti i parë i azhurnuar dyvjeçar për ndryshimet klimaterike

Të nderuar lexues,

Sado që të jemi konsekuent dhe përbushës në realizimin e përcaktimeve strategjike për mbrojtjen e mjedisit jetësor, rezultatet e arritura nuk do të jenë të plota nëse në to nuk i inkorporojmë politikat dhe masat për ballafaqim me ndryshimet klimatike në nivel nacional, por edhe në niveli global.

Republika e Maqedonisë si nënshkruese e Konventës kornizë të Kombeve të Bashkuara për ndryshime klimatike (UNFCCC), e veçanërisht Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, aktivisht punojnë në drejtim të përbushjes së detyrimeve vijuese, por edhe në përgatitjen e kapaciteteve nacionale për detyrimet e ardhshme ndaj Konventës dhe ndaj Unionit European.

Të vetëdijshëm që ta japim kontributin më të mirë të mundshëm nacional për zvogëlim të ndryshimeve klimatike dhe njëkohësisht të ecim drejt të ashtuquajturave ekonomi të “gjelbërta”, ndërmarrim një sërë aktivitetesh për vlerësim të mundësive nacionale për realizimin e këtij qëllimi të dhënë global.

Ky raport i përgatitur me mbështetje të Programit për zhvillim të Kombeve të bashkuara (UNDP), paraqet një kontribut të rëndësishëm të shtetit drejtë përbushjes së detyrimeve të caktuara të cilat janë relevante edhe për shtetet e UE-së, si që janë për shembull – rritja e sigurisë dhe përpikshmërisë të inventarit të gazrave serrë, vlerësimi i potencialit për zvogëlimin e ndryshimeve klimatike në të gjithë sektorët relevant si dhe determinimi i nevojave institucionale dhe të tjera për kanalizimin dhe inkorporimin e aspekteve të ndryshimeve klimatike në politikat nacionale dhe sektoriale.

Masat dhe aksionet e propozuara nga Raporti do të harmonizohen me Strategjinë e ardhshme nacionale për energjetikë, me çka me sukses do të përgjigjemi në rekomandimin e raportit të fundit të Unionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë në fushën e ndryshimeve klimatike, energjisë dhe harmonizimit të politikave nacionale me pakon evropiane për energji dhe klimë.

Nurhan Izairi
Ministër i mjedisit jetësor
dhe planifikimit hapësinor



Maqedonia: Raporti i parë i azhurnuar dyvjeçar për ndryshimet klimaterike – rezyme ekzekutive

Raporti i parë i azhurnuar dyvjeçar për ndryshimet klimaterike i konsolidon analizat e sektorëve për gazrat serrë dhe siguron transparencë për avancimin e Republikës së Maqedonisë në lidhje me aktivitetet për zbutjen e ndryshimeve klimaterike dhe të efekteve të tyre. Raporti i parë i azhurnuar dyvjeçar bazohet mbi gjetjet dhe rekomandimet e Planit të tretë kombëtar për ndryshime klimaterike (i dorëzuar në vitin 2014), dhe i përmban edhe informacionet për projektet aktuale komplementare në vendin tonë. Qëllimi përfundimtar i Raportit të parë të azhurnuar dyvjeçar për ndryshimet klimaterike është që t'i ndihmohet Republikës së Maqedonisë në orientimin dhe integrimin e gjetjeve për ndryshimet klimaterike në politikat kombëtare dhe sektoriale dhe të vazhdohet me përforsimin e kapaciteteve institucionale-teknike në lidhje me zbutjen e ndryshimeve klimaterike dhe me zhvillimin e qëndrueshëm. Shkalla e detajitetit dhe shkalla e analitikës së raportit është reflektim i statusit të Republikës së Maqedonisë si vend-kandidat për anëtarësim në UE dhe si palë kontraktuese në Bashkësinë energjetike – që do të thotë se vendi ka bërë përpjekje të konsiderueshme në përmirësimin e paraqitjes së vet, si në procesin e aktiviteteve dhe në zbutjen e efekteve.

1. Profil nacional

Sipas vlerësimeve të fundit¹, Republika e Maqedonisë ka popullatë në rritje e sipër, ndërsa për momentin numri i banorëve është 2.103.000.² Rreth 25% nga popullata jeton në kryeqytetin, pra në Shkup. Eksporti i mallrave dhe të shërbimeve është 53,8% nga bruto prodhimi vendor (BPV).³ Ekonomia kaq e hapur për një vend të vogël, e bëri Maqedoninë të cenueshme në ngjarjet e jashtme, siç ishte kriza ekonomike e vitit 2009. Prapëseprapë, para do kohësh, Republika e Maqedonisë arriti avancim të mirë në reformat ekonomike, ashtu siç konfirmohet me rritjen e BPV prej 7% midis viteve 2012 dhe 2013.⁴

Veprimtaritë e shërbimeve kontribuojnë me 62,3% në BPV, ndërsa ato industriale përfshijnë 27,5%⁵. Të dyja veprimtaritë janë të ndjeshme në gjendjen e ekonomisë. Sektori bujqësor, përfshirë edhe vlerën e shtuar në industrinë përpunuese, kontribuon me 10,2% në BPV të vendit dhe siguron punësim për 36% të fuqisë punuese. Pylltaria, gjithashtu, është e rëndësishme për ekonominë e Maqedonisë. Rreth 92% nga sipërfaqja e tërësishme me pyje ka karakter ekonomik, ndërsa rreth 8% janë pyje mbrojtëse dhe pyje të mbrojtura. Bujqësia dhe ekonomitë rurale të bazuara mbi resurset natyrore janë posaçërisht të cenueshme ndaj presioneve të ndryshme antropogjene, përfshirë edhe rreziqet klimaterike, variacionet dhe ndryshimet afatgjate klimaterike.

¹ Republika e Maqedonisë, popullatë: viti 2013. Vlerësimet më të reja statistikore për popullatën nga regjistrimi i fundit në vitin 2002. <http://countryeconomy.com/demography/population/macedonia>

² Pa marrë parasysh se shkalla e fertilitetit në vend është në rënje e sipër, njëlloj si në Evropë, popullatë shënon trend të tatëpjetë.

³ FMN Pasqyra botërore ekonomike, prill i vitit 2014. <https://www.gfmag.com/global-data/country-data/macedonia-gdp-country-report>

⁴ Enti shtetëror i statistikës i Republikës së Maqedonisë http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstanie_en.aspx?rbtxt=32

⁵ CIA, Libri botëror i fakteve.

Krahas ekonomisë së llojlojshme e cila është në përmirësim e sipër, Maqedonia ende ka hapësirë për përmirësim në raport me prodhimin e energjisë. Prodhimtaria e energjisë elektrike vjen kryesisht nga termo-elektrocentrale të vjetërsuara që punojnë me thëngjill, në të cilat bie rreth 66% të prodhimit të rrymës elektrike. Hidrocentralet prodhojnë rreth 34% nga rryma elektrike.⁶ Sektori banesor dhe komercial përbëjnë pothuajse 70% nga kërkesa për energji elektrike, ndërsa në industrinë bie ~ 30% nga kërkesa. Sektori i transportit përfshin pothuajse 25% nga kërkesa për energji, e cila thuajse e tëra është nga prodhime të naftës së importuar, sepse në këtë drejtim nuk ekziston prodhimtari vendore.

Në sektorin transportues, komunikacioni rrugor ka pjesëmarrje më të madhe në shpenzimin e energjisë (98%) dhe është dominues në sektorin transportues në tërësi. Nga viti 2000, ka rënie të konsiderueshme të konsumit të benzines dhe rritje të konsiderueshme të lëndëve djegëse dizel, sepse automjetet me dizel bëhen gjithnjë e më atraktive. Parku i automjeteve në përgjithësi është shumë i vjetër, me vjetërsi mesatare të automobilave prej 15 vjet.⁷ E njëjta vlen edhe për autobusët dhe automjetet për ngarkim.

2. Aranzhmane institucionale në përkrahje të zbutjes së ndryshimeve klimaterike

Ministria për ambient jetësor dhe planifikim hapësinor (MAJPH) është përcaktuar si Trup kombëtar për kontakt të Konventës kornizë të KB për ndryshimet klimaterike (UNFCCC) dhe si Organi i përcaktuar nacional për implementim të Protokollit nga Kjoto. Ministritë e tjera të cilat kanë kompetenca në lidhje me ndryshimet klimaterike janë Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, Ministria e ekonomisë, Ministria e transportit dhe lidhjeve, Ministria e shëndetësisë dhe Ministria e financave. Komiteti nacional për ndryshime klimaterike (KNNK) siguron përkrahje dhe drejtime në nivel më të lartë për politikën e gjithëmbarshme për ndryshimet klimaterike në vend, ndërsa Këshilli nacional për zhvillim të qëndrueshëm këshillon për çështjet ekonomike.

Çështjet e ndërlidhura me ndryshimet klimaterike janë të vendosura në Ligjin për ambientin jetësor, përfshirë edhe detaje për përpilim të inventarizimeve për shkarkime të gazrave serrë. Ligji, gjithashtu, përfshin edhe plan aksionar për masa dhe aktivitete për zvogëlim të rritjes së emetimeve të gazrave serrë dhe për zbutje të ndikimeve të pavolitshme të ndryshimeve klimaterike. Në decenien e kaluar, janë miratuar disa ligje, rregullativa dhe strategji të cilat përfshijnë gjetje për zbutjen, siç janë Strategjia për zhvillim të energjetikës në Republikën e Maqedonisë për periudhën e viteve 2008-2020 me vizion deri në vitin 2030 (2010), Strategjia për burime të rinovueshme e Maqedonisë deri në vitin 2020 (2010) dhe Strategjia nacionale për efikasitet energjetik në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020 (2010). Gjithashtu, Qeveria miratoi tetë ligje për ratifikim të pesë protokolleve të Komisionit ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECEP), Konventa për ndotje tejkufitare të thellë të ajrit.

Me tre planet nacionale për ndryshime klimaterike të parashtruara në UNFCCC në vitin 2003, 2008 dhe 2014, bashkësia ndërkombëtare është informuar në mënyrë përkatëse për aktivitetet për zbutje që i ndërmerr Republika e Maqedonisë për zgjidhje të çështjes së ndryshimeve klimaterike. Në kontekst të procesit të aderimit ndaj Unionit Evropian (UE) (prioritet i lartë për

⁶ Banka botërore (2013) 10 fakte për sektorin energjetik në IRJ të Maqedonisë.
<http://www.worldbank.org/en/news/video/2013/07/23/macedonia-energy>.

⁷ Vetëm për krahasim, në vitin 2011, në Slloveni numri i automjeteve për pasagjerë në 1000 banorë ishte 519, me vjetërsi mesatare të automobilave prej 8,4 vite.

Maqedoninë), Republika e Maqedonisë tanimë e filloi procesin e harmonizimit të qasjes së vet ndaj zbutjes në drejtim të obligimeve të UE ndaj UNFCCC dhe pjesëve të *acquis communautaire* të UE në lidhje me ndryshimet klimaterike. Si anëtare e UE, Maqedonia do të jetë e obliguar të merr pjesë në sistemin e UE për tregtim me shkarkime (UE ETC).

Me obligimet ndaj UNFCCC dhe UE, Strategjia e Maqedonisë për zhvillim të energjetikës ofron një set të qëllimeve ambicioze dhe konkrete numerike për vitin 2020, duke e vijuar politikën e ndryshimeve klimaterike të UE. Çmimet përfshijnë zvogëlim të intensitetit energjetik të ekonomisë për 30% në raport me vitin 2006 dhe rritje të pjesëmarrjes së burimeve të rinovueshme të energjisë (duke përfshirë hidroenergjinë dhe ngrrohtësi nga drurët) në mbi 20% nga energjia e tërësishme përfundimtare. Pjesëmarrja e burimeve të rinovueshme (me përjashtim të biomasës) në energjinë e përgjithshme primare pritet të rritet për 119% në periudhën e viteve 2011 - 2050, kryesisht si rezultat i rritjes së pritur të kapacitetit të errës (Plani i tretë nacional për ndryshime klimaterike). Prapëseprapë, gjysma e energjisë elektrike në vend ende është e projektuar të vjen nga termocentralet me thëngjillin linjit, si në vitin 2020, ashtu edhe në vitin 2030, ndërsa kërkesa e tërësishme e përgjithshme për energji elektrike është projektuar të rritet për rreth 52% deri në vitin 2030.

3. Inventarizimi i gazrave serrë

Republika e Maqedonisë zbatoi një inventarizim nacional të shkarkimeve antropogjene sipas burimeve dhe rrënieve për mënjanim të të gjitha gazrave serrë (GHG) për tu identifikuar burimet kryesore dhe mënjanimet/rrënie të gazrave serrë me siguri më të madhe, që mandej tu përmbahet qëllimeve të veta dhe të jep informacione për vendimet politike. Inventarizimi përfshin bazë të të dhënave për gjashtë gazra të drejtpërdrejta: CO₂, CH₄, N₂O, PFCs, HFCs dhe SF₆, dhe katër gazra të tërthorta: CO, NO_x, NMVOC и SO₂. Ai bazohet mbi punën për Planin e tretë nacional për ndryshimet klimaterike, në të cilin është marrë korniza kohore në vitet 2003-2009 dhe i cili është përgatitur në pajtim me Udhëzimet e reviduara të IPCC të vitit 1996 për inventarizimet nacionale të gazrave serrë dhe Udhëzimin për praktika të mira të IPCC nga viti 2000. Për raportimin për trendet më të reja të gazrave serrë në Raportin e parë të azhurnuar dyvjeçar, inventarizimi nga Plani i tretë nacional është sendërtuar për të marrë parasysh edhe periudha e viteve 1990 - 2012 me ndihmë të softuerit më të ri për inventarizime të IPCC nga viti 2006.


Përgatitja e inventarizimit të gazrave serrë u koordinua nga Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor dhe u menaxhua nga ekipi për përpilim të inventarizimit të GHG me përkrahje nga këshilltari nacional teknik dhe nga Programi nacional për përkrahje të raportit (PNPR). Garantimi i cilësisë/kontrollit të cilësisë u siguroa përmes procesit të formalizuar të pyetjeve dhe të përgjigjeve, bashkë me komentet nga ekspertët nacional nga Akademia e shkencave dhe e arteve e Maqedonisë. PNPR siguroi revizion nga një konsulent me përvojë i cili propozoi përmirësime në përgatitjen e një vargu të të dhënave gjithëpërfshirëse, të detajuar dhe të plotë të shkarkimeve.

Neto shkarkimet e tërësishme në trërë periudhën e inventarizimit nga viti 1990 deri në vitin 2012 tregoi rritje të vogël prej 0,4% në raport me vitin 1990. Pesë kategoritë më të mëdha kyçe të burimeve të shkarkimeve në Maqedoni janë:

- Shkarkime të CO₂ nga industrinë për energjetikë (thëngjill, liniit) (49,5%);
- Shkarkime të CH₄ nga landfilet për mbetje të ngurta (11,7%);
- Shkarkime të CO₂ nga djegiet nga automjetet, përfshirë edhe automjetet (11,6%);
- Industri prodhuese dhe ndërtimtaria (8,8%); dhe

- Shkarkime të CH₄ nga fermentimi enterik të kafshëve shtëpiake (3,9%).

Në përgjithësi, pjesëmarrja në shkarkimet të gazrave serrë sipas sektorëve për periudhën e viteve 1990 - 2012 është pasqyruar në fotografinë 1.



Fotografija 1: Pjesëmarrja sipas sektorëve të gazrave serrë në periudhën 1990-2012

Industritë prodhuese dhe nënsektori ndërtimtari ishin të dytat sipas pjesëmarrjes në shkarkimet në vend me pjesëmarrje mesatare prej 3,6% në vitin 1990. Në vitin e fundit për inventarizimin, vitin 2012, ky sektor ishte përgjegjës për 8,82% nga shkarkimet e gazrave serrë në vendin tonë, e me këtë konsiderohej si i katërt sipas pjesëmarrjes. Ashtu, shkarkimet nga nënsektori prodhimtari kanë trend të rrënies, gjë e cila ka të bëjë me aktivitetin e zvogëluar industrial në vend, dhe që pjesërisht shpjegohet me mbylljen e reparteve prodhuese të aluminit, plumbit dhe zingut në vitin 2003.

Përkundrazi kësaj, shkarkimet nga nënsektori komunikacioni rrugor përjetoi rritje të konsiderueshme në periudhën e viteve 1990 - 2012; pjesëmarrja mesatare në shkarkimet e këtij nënsektori në vitin 1990 ishte 6,2% në shkarkimet e tërësishme nacionale, ndërsa në vitin 2012 ky nënsektor ishte përgjegjës për 11,6% nga shkarkimet e tërësishme nacionale. Ngjashëm me këtë, shkarkimet nga nënsektori për depozitimin e mbeturinave të ngurta u rritën në mënyrë të konsiderueshme në periudhën e viteve 1990 - 2012 për shkak të rritjes së popullatës, gjë e cila solli konsum më të madh dhe krijim të mbeturinave. Në kategorinë e shfrytëzimit të tokës dhe ndryshimet në shfrytëzimin e tokës dhe pylltarisë, shkarkimet ishin relativisht të pandryshuara, përveç në vitet 2007, 2008 dhe 2012 kur rrëniet e karbonit u zvogëluan në mënyrë të konsiderueshme, për shkak të zjarreve të mëdha pyjore. Në sektorin bujqësor, pjesa më e madhe e shkarkimeve të CH₄ (89%) u prodhuan me fermentim enterik të kafshëve shtëpiake dhe këto shkarkime dhe këto shkarkime janë në rrënie të vazhdueshme paralelisht me zvogëlimin e popullatave të bagëtive. Në shkarkimet nga plehu organik biejnë 8% nga shkarkimet e gazrave serrë, ndërsa shkarkimet e tjera vijnë nga fushat e prodhimit të orizit dhe djegija e plehrave.

Për tu përmirësuar raportimi i ardhëshëm rreth të dhënave nga inventarizimi për energjetikën, proceset industriale, bujqësia, pylltaria dhe shfrytëzimi tjetër i tokës dhe sektoreve për mbeturina, rekomandohet që të përpilohen faktorë shkarkimi që janë specifik për lëndët djegëse dhe djegjen në komunikacionin rrugor dhe hekurudhor. Për sektorin procese industriale, në të ardhmen patjetër duhet të shfrytëzohet platforme aktive, onllajn e quajtur Monitorim i shkarkimeve në industrinë (MSHI) me të cilën impianteve industriale ju mundësohet të paraqesin të dhëna për përlogaritje të shkarkimeve të gazrave serrë dhe ndotës të tjerë për përpilimin e inventarizimeve. Për sektorin bujqësor, rekomandohet qasje në nivel të dytë të vlerësimit të shkarkimeve të metanit nga ferementimi enterik nga bagëtia.

4. Aktivitete të zbutjes

Analiza e zbutjes në Raportin i parë i azhurnuar dyvjeçar është vazhdimësinë e zbutjes së ndryshimeve klimaterike të zbatuar në Raportin e parë të azhurnuar dyvjeçar është vazhdimësi të analizës të zbatuar në Planin e tretë nacional. Duke i marrë parasysh ndryshimet të cilat ndodhën ndërkohë, u revidua skenari i parë nisës që është reflektim i zhvillimit pa zbatimin e masave për zbutje, e ashtuquajtur i skenar pa masa (**WOM-skenari**). Më tej, me ndihmë të qasjes **nga poshtë-lartë** dhe duke filluar nga masat konkrete për zbutje në sektorin **ndërtimor, transportues dhe energjetik**, çdo masë dhe potenciali i saj i zbutjes (zvogëlimi i realizueshëm i shkarkimeve) është i modeluar në mënyrë veç-e-veç dhe janë përlogaritur shpenzimet konkrete të zbutjes.

Masat të cilat kanë shkallë relativisht të lartë të sigurisë së implementimit (ata të cilat tanimë janë të filluara/të planifikuara në të ardhmen e afërt, të cilat janë rezultat i ligjeve që tanimë janë të miratuara ose do të miratohen në të ardhmen e afërt) janë të ashtuquajturat masa ekzistuese (**WEM-skenar**). Skenari me masa shtesë (**WAM-skenar**) u krijua për shkak të vendosjes së prioriteteve në aktivitetet e mëtejme dhe të masave në zbutjen si dhe për analizimin e ambicieve më të larta.

U tregua se sipas WOM-skenarit, shkarkimet aktuale do të rriten pothuajse dyfish deri në vitin 2030, me dominim të shkarkimeve nga sektori energjetik (pjesëmarrje nga 60% deri në 70%). Me 11 masat të përfshira në WEM-skenarin, mund të arrihet zvogëlim maksimal të shkarkimeve prej 32% në vitin 2030 në raport me nivelin e shkarkimeve nga WOM-skenari. Më tej me WAM-skenarin, i cili përfshin 14 masa (8 WEM-masa, 3 WEM-masa të përmirësuara dhe 3 masa shtesë), mund që për 37% të zvogëlohet niveli i shkarkimeve nga WOM-skenari për vitin 2030 (Tabela 1).

Tabela 1: Rezultate lumare për shkarkime të CO₂ në vitet 2020, 2030 dhe në mënyrë kumulative deri në vitin 2020 dhe 2030 në skenarët WOM, WEM dhe WAM

	WOM	WEM	WAM
CO ₂ shkarkime në 2020 (kt)	11,561	9,269	8,694
CO ₂ shkarkime në 2030 (kt)	17,891	12,124	11,214
CO ₂ shkarkime kumulative deri në vitin 2020 (kt)	90,033	80,007	79,348
CO ₂ shkarkime kumulative deri në vitin 2030 (kt)	212,634	173,301	165,032
Zvogëlim në raport me WOM (CO ₂ shkarkime në vitin 2020)		20%	25%
Zvogëlim në raport me WOM (CO ₂ shkarkime në vitin 2030)		32%	37%

Zvogëlim në raport me WOM (CO ₂ shkarkime kumulative deri në vitin 2020)		11%	12%
Zvogëlim në raport me WOM (CO ₂ shkarkime kumulative deri në vitin 2030)		18%	22%

Duhet theksuar se rezultatet e kësaj analize janë indikative dhe duhet të shfrytëzohen gjatë përcaktimit/definimit të pjesëmarrësve nacional në përpjekjet globale për zbutje (UNFCCC-proces). Krahas kësaj, duke pasur parasysh se WOM, WEM dhe WAM-skenarët janë element kryesor për raportimin rreth përpjekjeve nacionale për zbutje në vendet nga Aneksi I, përfshirë edhe vendet-anëtare të UE, ky ushtrim, gjithashtu kontribuoi për ndërtimin e kapaciteteve në vendin, si ato analitike, ashtu edhe kapacitetet e krijuesve të politikave dhe të të gjithë faktorëve për përgjigje të kërkesave gjithnjë e më të mëdha të raportimit.

Më në fund, duke i marrë parasysh edhe analizat e zbutjes të zbatuara në kuadër të Planit të tretë nacional për ndryshime klimaterike, është prezantuar formë tabelore të aktiviteteve të ndryshme për zbutje të cilat Republika e Maqedonisë për momentin i realizon dhe ka ndërmend ti zbatojë në decenien e ardhshme. Për ato të cilat për momentin i zbaton, janë të kyçura edhe inflacione për hapat që janë ndërmarrë deri tani. Llojet e aktiviteteve për zbutje përfshijnë:

- Promovim i efikasitetit energjetik të shfrytëzuesit përfundimtar;
- Rritje e shkallës së burimeve të rinovueshme të energjisë në prodhimin e energjisë elektrike dhe të ngrohjes;
- Përmirësim i sistemeve transportuese dhe parkut të automjeteve;
- Nxjitje e kalimit nga lëndë djegëse me shkallë të lartë të karbonit drejtë lëndë djegëse me shkallë të ulët të ulët të karbonit;
- Përmirësim i menaxhimit me mbeturinat;
- Përmirësim i menaxhimit me bujqësinë përmes metodave të ndryshme ekonomike.

5. Matje, raportim dhe verifikim (MRV)


Me qëllim të raportimit rreth avancimit me aktivitetet për zbutje të ndryshimeve klimaterike, Maqedonia filloi të zhvillojë sistem të matjes, raportimit dhe verifikimit (MRV). Si vend-kandidat për anëtarësim në UE dhe palë kontraktuese në Bashkësinë energjetike Evropiane, Maqedonia do të duhet të parashtrojë raporte për të gjitha aktivitetet e veta për zbutje të cilat i reflektojnë obligimet e tilla. Më me relevantë, këto kërkesa për raportim i përfshijnë kursimet nga programet për efikasitet energjetik, pjesëmarrjen e burimeve të rinovueshme të energjisë, si dhe nivelin e shkarkimeve nga impiantet/djegësit e mëdhenj industrial. Maqedonia është e detyruar ti raportojë UE me ndihmë të formatit të përbashkët të raportimit, të cilin UE e përdor zakonisht, dhe i cili jo vetëm që është në pajtim me standardet e raportimit të UNFCCC, por edhe në shumë raste shkon shumë më larg nga UNFCCC. Këto kërkesa për raportim tanimë janë shumë më larg nga kërkesat për vendet e tjera të cilat nuk janë në Aneksin I.

Vendi përcaktoi dy grupe të veçanta të indikatorëve “të vendit”, të cilat mund të shfrytëzohen për qëllimet e MRV. E para, MAJPH përpiloi një grup indikatorësh për ambientin jetësor në vitin 2012. E dyta, dhe mund edhe më me relevantë, Enti shtetëror për statistikë përcaktoi indikatorë për zhvillim të qëndrueshëm në vitin 2014.⁸ Këto indikatorë më shumë-më pak janë të përgjithshëm dhe e masin avancimin në makro-nivel, dhe mundet nuk janë të përdorshëm për

⁸ http://www.stat.gov.mk/Publikacii/Odrzliv_Razvoj_2014.pdf

matje të avancimit gjatë aktiviteteve më të vogla për zbutje. Prandaj, si pjesë e përgatitjeve të Raportit të parë të azhurnuar dyvjeçar, lista e parë potenciale gjithëpërfshirëse e indikatorëve e propozuar në “Kornizën konceptuale dhe rrugën e monitorimit, raportimit dhe verifikimit (MRV) të aktiviteteve për zbutje të ndryshimeve klimaterike në Maqedoni” do të mundësojë vendit që ta përmirësojë MRV-sistemin e tanishëm dhe të mund ta matë avancimin në përmasa më të vogla (për shembull, në projekte individuale me metrikë të zbërthyer). Një nga rekomandimet kyç është të zhvillohen indikatorë për matje të përfitimeve shtesë më qëllim të raportimit më preciz për zhvillimin ekonomik-social.

Rruga për vendosje të MRV-kornizës në Maqedoni qëndron në pesë hapa të përgjithshme. Çdonjëri nga hapat përfshin procese dhe vështirësi të veta konkrete. Disa hapa do të përcaktohen drejtpërdrejtë nga rezultatet e analizës së mëtejme. Pesë hapat janë:



6. Trajnime dhe përkrahja që janë marrë

Maqedonia fitoi përforsim të konsiderueshëm të kapaciteteve i cili i ndihmoi në përgatitjen e Raportit të parë të azhurnuar dyvjeçar për ndryshimet klimaterike midis shtatorit të vitit 2013 dhe dhjetorit të vitit 2014. Me trajnime u përkrahën ekipi për inventarizim të gazrave serrë dhe ekipi për ndryshime klimaterike për ti përmirësuar dituritë dhe kapacitetet e veta teknike për zbutje, monitorin, lajmërim dhe vlerësim (MRV), modelim në softuerin për zbutje, zhvillim të politikave klimaterike, tërheqje të mjeteve financiare për klimën, si dhe ndërlidhje të klimës me shëndetin.

Në lidhje me financimin e projektit dhe në përgjithësi në lidhje me ndryshimet klimaterike, Unioni Evropian dhe programet e tij siguruan shumë më të lartë të donacioneve, përkatësisht 34,4% nga mjetet për realizim të projektit. Kombet e Bashkuara me programet e veta marrin pjesë me 11,1% në financimin e tërësishëm, ndërsa FGSH morri pjesë me 9% në financimin e projektit.

Gjithashtu, me përkrahje nga Fondi për inovacione të UNDP, u promovuan inovacione, ndërsa aplikacioni Udhëto gjelbër (Skopje Green Route) është shembull për praktikë më të mirë të ballafaqimit me ndryshimet klimaterike dhe transportin. Deri tani, aplikacioni ka numër të madh

të shfrytëzuesve⁹ dhe është e botuar në mjetet e informimit të UE për shkak të suksesit të arritur. Në mënyrë plotësuese, përmes projektit Milieucontact Makedonija të financuar nga USAID, 8 komuna në vendin tonë zhvilluan inventarizime për gazrat serrë në nivel lokal.

7. Mangësi në kapacitetet dhe përkrahja e nevojshme

Për tu përmbushur obligimet të cilat burojnë nga vendimet e Konferencës së palëve të UNFCCC në Kankun dhe Durban në lidhje me planet nacionale dhe raportet të azhurnuara dyvjeçare për ndryshimet klimaterike, nevojitet përkrahje e mëtejme për të vazhduar me zhvillim dhe konsolidim të kapaciteteve ekzistuese teknike dhe institucionale dhe për të vazhduar me përpjekjet për integrimin e ndryshimeve klimaterike në politikat, planet dhe programet nacionale.

Më saktë, nevojitet përkrahje teknike për të siguruar kontroll të cilësisë së procesit nacional të bërjes së inventarizimit të gazrave serrë. Përveç kësaj, nevojitet përkrahje e vazhdueshme administrative dhe financiare për tu garantuar vazhdimësia dhe integriteti në procesin e gazrave serrë. Në lidhje me këtë, duhet të përdoren mekanizmat për financim të intervenimeve klimaterike për shkak të qëndrueshmërisë së tyre.

8. Perspektiva gjinore

Maqedonia është e vetëdijshme se edhe burrat edhe gratë duhet patjetër të marrin informacione për ndryshimet klimaterike dhe patjetër duhet të marrin pjesë në miratimin e vendimeve. Si rezultat të kësaj, Republika e Maqedonisë ka zhvilluar disa instrumente për ti bërë vështrim dimensionit gjinor të zbutjes së ndryshimeve klimaterike gjatë zhvillimit të politikave në nivel nacional dhe lokal edhe të transferimi i teknologjisë.

Për përmirësim të përfitimeve nga zbutja e ndryshimeve klimaterike për gratë në sektorët e ndryshëm, u përcaktuan pika hyrëse. Për momentin, në sektorin energjetik dhe transportues, gratë e pamartuara dhe amvisëritë me një ushqyes të tyre janë më pak të afta për ti absorbuar shpenzimet në rritje e sipër për ngrohje, ftohje dhe transport për shkak se në përgjithësi fitojnë paga më të ulëta. Me planet e shtetit për zbutje të ndryshimeve klimaterike, gratë do të jenë shfrytëzuese të drejtpërdrejta të zvogëlimit të shkarkimeve përmes përmirësimit të efikasitetit energjetik në shtëpinë dhe transportin publik. Ngjashëm me këtë, në bujqësinë, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm të grave në fermat familjare, gratë që merren me bujqësi do të trajtohen në praktika për zvogëlim të shkarkimeve të gazrave serrë siç janë bujqësia organike dhe menaxhimi i qëndrueshëm me truallin. Aktivitetet e tilla janë me qëllim të zvogëlimit të disparitetit të tanishëm gjinor në Maqedoni, duke i rritur njëkohësisht përfitimet pozitive nga zbutja e ndryshimeve klimaterike.

⁹ #SkopjeGreenRoute është hashtagu i dytë më i popullarizuar në Tuitur në Maqedoni